

FORMA E SHKURTUAR E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË VETË MJETIT MOTORRIK (KASKO)

MBULIMET QË OFRON KONTRATA E SIGURIMIT

Mbulimi 1. Përplasje, Përmbysja

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorrik nga:

- Përplasje me një objekt fikse ose të lëvizshëm.
- Përmbysja e mjetit motorrik.

Siguruesi, në rastin e ndodhjes së aksidentit paguan shpenzimet e transportit për mjetin dhe personat që ndodhen në të, deri në vendmbërritje (brenda Shqipërisë) sipas çmimeve të tregut dhe distancës së lëvizjes.

Mbulimi 2. Zjarri, Eksplozioni dhe Rrufeja

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet e mjetit motorrik nga:

- Zjarri dhe Eksplozioni që vijnë nga faktorë të jashtëm dhe përfshijnë mjetin e siguruar.
- Rrufeja mbi mjetin motorrik.

Nuk mbulohen:

- Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni, që vijnë nga shkaqe të brendshme të mjetit motorrik.
- Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni ku shkak ka qenë pirja e duhanit në mjetin motorrik.
- Dëmet kur aksidenti nuk është njoftuar në polici apo në repartin zjarrfikës.

Mbulimi 3. Katastrofa Natyrore

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet e mjetit tuaj shkakuar nga:

Stuhia, Breshëri, Dëbora, Tufani, Përmbytja, Vërshimi, kur katastrofa natyrore është e njohur nga autoritetet përkatëse shtetërore.

Nuk mbulohen:

- Dëmet nga tërmeti dhe rrëshqitja e tokës.
- Dëmet e shkaktuara gjatë kalimit të lumenjve ose pellgjeve.

Mbulimi 4. Vjedhja

Vjedhje do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në mënyrë të fshehtë, nga një ose disa persona, i mjetit motorrik të siguruar (vjedhje totale) ose i pjesëve apo aksesorëve të tij (vjedhje e pjesshme).

Tentativë për vjedhje do të konsiderohet çdo veprim që ka synuar vjedhjen e mjetit motorrik të siguruar ose të pjesëve të tij, por që nuk ka mundur të kryhet, duke shkakuar dëme ndaj mjetit motorrik.

Nuk mbulohen:

- Dëmet nga vjedhja nëse ato janë kryer nga i Siguruari ose përdoruesit, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit.
- Dëmet nga vjedhja ose tentativë vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose çelësat e mbylljes janë lënë brëndë mjetit, mbi/ose përreth tij.
- Dëmet nga vjedhja e pjesëshme me shkaqe të pashpjegueshme pa shënja e gjurmë të dukshme.
- Vjedhja e pajisjeve të tilla si autoradio, antena, autoparlante, përveç vjedhjes totale të mjetit motorrik të siguruar.
- Vjedhja me dhunë.

Mbulimi 5. Thyerja e Xhamave

Thyerje e xhamave do të kuptohet që nga plasaritja deri tek thërmimi i xhamave të përparëm, të prapëm, anësorë, të tavanëve të lëvizshëm si dhe xhamave të fenerëve të shkakura nga goditja e një objekti të lëvizshëm.

Nuk mbulohen:

- Dëmet e shkaktuara në mbulesat ose perdet mbrojtëse nga dielli.
- Dëmet në çdo xham tjetër që nuk përfshihet në katalogun e prodhimit, por që është vendosur në mjetin motorrik.

PËRJASHTIMET E PËRGJITHSHME

Çfarë nuk është e Mbuluar:

- Dëmet e shkaktuara qëllimisht dhe/ose të udhëzuara nga personi i Siguruar.
- Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, invazionit, veprimeve të tjera të armatosura panvarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta civile, turbullira civile, revolucione, lëvizja separatiste, kryengritja popullore, rebelimit, revolta, puçe, grushte shteti, eksode, akteve terroriste, trazirave, grevës, sabotimit.
- Dëmet që vijnë si rezultat i shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor, ndotjes radioaktive, rrezatimeve jonizuese, ndotjeve kimike.
- Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit.
- Dëmet që shkaktohen nga përdorues, emrat e cilëve nuk janë shënuar në kontratën e sigurimit.
- Dëmet që rezultojnë nga konsumi normal, defektet apo avaritë e brendshme elektrike apo mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit.
- Prerja apo skopjimi i gomave, si dhe dëmet që pasojnë.
- Dëmtimet e disqeve të gomave, kur paraqiten si dëmtim i vetëm, jo pasojë aksidenti.
- Dëmet në mjetin motorrik të siguruar në operacione të tilla si: shërbimi, riparimi, kontrolli, larja, parkimi, dorëzimi ose shitja.
- Dëme të shkaktuara nga përdoruesit e pa pajisur me dëshminë e aftësisë për drejtimin e mjetit.
- Dëmet e shkaktuara kur drejtuesi i mjetit ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit e të drogës ose refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli.
- Dëmet e shkaktuara në mjet nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive, gërryese, dezëze, jonizuese etj. Siguruesi do t'i paguajë këto dëme nëse është rënë dakord më parë duke paguar një prim shtesë.
- Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e rastit të sigurimit.
- N. Siguruesi s'do të mbulojë zmadhimin e humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos thellohen ato. Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të bëra që nuk lejojnë që të zmadhohen dëmet ose humbjet.
- O. Dëmet që mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm në sektorin e transportit (DMTPL).

Lidhja e Kontratës. Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në datën e lëshimit të saj, me kusht që të jetë paguar më parë primi i sigurimit ose kësti i tij i parë.

Kalimi i të Drejtave. Të drejtat dhe detyrat e të Siguruarit në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Miratimi do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në Policë (kontratën e sigurimit). Kontrata (Policë) mbaron në ditën e rastit të sigurimit si rezultat i të cilit mjeti motorrik i siguruar është dëmtuar totalisht ose është vjedhur. Në këtë rast primi i sigurimit nuk kthehet.

Pjesa e Zbritshme. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe/ose franshizë. Për çdo rast dëmi, Siguruesi do të zbrisë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit në shumë absolute ose në përqindje.

Sigurimi të Tjera. Nëse i Siguruari kryen sigurim tjetër të mjetit, ai duhet t'i njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesit, emrin e Siguruesit tjetër dhe shumën e siguruar. Kur i Siguruari me dashje ose për shkak të pakujdesisë nuk plotëson detyrimet e mësipërme, atëherë Siguruesi ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës së sigurimit dhe mospagimit të dëmshpërblimit. Polica (kontrata e sigurimit) quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

Mbisigurimi. Nëse shuma e siguruar e tejkalon ndjeshëm vlerën e mjetit motorrik, atëherë si Siguruesi ashtu edhe i Siguruari mund të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguruar dhe primi i sigurimit do të pakësohet përkatësisht. Nëse i Siguruari lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primimit të sigurimit. Në qoftë se ndodh rasti i sigurimit (dëmtim total apo vjedhje e plotë), Siguruesi ka të drejtën e zëvendësimit të mjetit të dëmtuar me një mjet tjetër i së njëjtës markë e model.

Nënsigurimi. Nëse në momentin menjëherë pas ndodhjes së rastit të sigurimit shuma e siguruar është më e ulët se vlera e mjetit motorrik, dëmshpërblimi i llogaritur do të shumëzohet me koeficientin e nënsigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së siguruar ndaj vlerës së mjetit.

Njoftimi i Rastit të Sigurimit. I Siguruari ose përfaqësuesi i tij, që kërkon të dëmshpërblehet për dëmet në mjetin motorrik të siguruar, janë të detyruar që menjëherë të njoftojë rastin e sigurimit. Rasti i sigurimit kupton ndodhjen gjatë së cilës mjeti motorrik përfshihet në një aksident ose vjedhje.

- Njoftimi i rastit të sigurimit duhet të bëhet brenda 48 orëve nga momenti i ndodhjes së aksidentit pranë Degës INTERSIG - Vienna Insurance Group sh.a, në territorin e së cilës ndodhet agjencia që ka lëshuar Policën (kontratën e sigurimit) ose pranë Degës më të afërt.
- Në rastin e vjedhjes, lajmërimi dhe denoncimi pranë Organeve të Policisë duhet të bëhet brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes.
- Në rastin e zjarrit, eksplozionit dhe rrufes, lajmërimi pranë zjarrefiksive më të afërt nga vendi i ngjarjes duhet të jetë i menjëhershëm dhe jo më larg se 24 orë nga momenti i ndodhjes të rastit të sigurimit.
- Në rastin e thyerjes së xhamit lajmërimi duhet të bëhet brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes apo konstatimit të rastit të sigurimit pranë degës INTERSIG - Vienna Insurance Group sh.a, në territorin e së cilës ndodhet agjencia që ka lëshuar Policën (kontratën e sigurimit).
- Kopja që dëshmon për lajmërimin dhe denoncimin pranë këtyre organeve i vihet në dispozicion Siguruesit së bashku me Njoftimin e Rastit të Sigurimit jo më vonë se 48 orë nga momenti i ndodhjes.
- Formulari Standard i njoftimit të rastit të sigurimit, i përgatitur më parë nga Siguruesi duhet të plotësohet me besnikëri dhe në afatet e mësipërme, pa shtrembërime të fakteve të rastit të sigurimit nga i Siguruari. Në rast të kundërt, Siguruesi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit.

Vlerësimi i Dëmit. I Siguruari për dëmet në mjetin e siguruar, paraqet kërkesën për dëmshpërblim brenda afateve të parashikuara nga Ligji, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit të sigurimit nëpërmjet formularit standard.

- Siguruesi gëzon të drejtën për të verifikuar vërtetësinë e rastit të sigurimit si dhe të madhësisë së dëmit. Brenda 10 ditëve nga momenti që është njoftuar për rastin e sigurimit, Siguruesi përfundon ekspertimet e nevojshme, ndërsa mjeti mbahet pa i riparuar nga i Siguruari gjatë kësaj periudhe.
- Kërkesa për dëmshpërblim i drejtohet Degës INTERSIG - Vienna Insurance Group sh.a, në territorin e së cilës ndodhet agjencia që ka lëshuar Policën (lidhur kontratën). I Siguruari është i detyruar të paraqesë kur i kërkohen të gjitha dokumentat e nevojshme që kanë lidhje me rastin e sigurimit.
- Vlerësimi i dëmit duhet të jetë brenda Limitit të Përgjegjësive.
- Në rast mosmarrëveshje, por vetëm pasi Siguruesi ka ofruar vlerësimin e tij, të dy palët krijojnë një komision arbitrazhi të paanshëm, me pjesëmarrjen e ekspertëve të secilës palë dhe të një eksperti të tretë. Shpenzimet e këtij komisioni përcaktohen në momentin e krijimit të tij nga palët.

Limiti i Përgjegjësive. Limiti i përgjegjësive për dëmet në mjetin e siguruar është:

- Vlera e nevojshme për riparimin e mjetit të dëmtuar ose shumën në CASH për të zëvendësuar dëmin sipas vlerës së tregut në Shqipëri në momentin e ndodhjes së dëmit.
- Vlera e mjetit të vjedhur ose dëmtuar totalisht sipas vlerës së tregut në Shqipëri në momentin e ndodhjes së dëmit, por jo më shumë se shuma e siguruar. Pjesët që mbeten të padëmtuara do të zbriten nga vlera aktuale. Vlerësimi i këtyre pjesëve është i ngjashëm me vlerësimin e dëmit. Siguruesi nuk është i detyruar të mbajë vlerën e pjesëve të mbetura të padëmtuara, përveç rasteve kur bihet dakord midis palëve.

Pagesa e Dëmit. Siguruesi do të paguajë të Siguruarin ose trashëgimtarin i tij për dëmet në mjetin motorrik të siguruar deri në limitin e përgjegjësive duke zbritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në Policë (kontratën e sigurimit). Dëmet me vlerë më të vogël se Franshiza e përcaktuar në kontratë, nuk paguhen.

Siguruesi do të paguajë dëmet brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për dëmshpërblim dhe pas dorëzimit të dokumentave të nevojshme të kërkuara prej tij.

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve. Mosmarrëveshjet midis Siguruesit dhe të Siguruarit kur nuk zgjidhen me mirekuptim, do të zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lëshuar Polica e Sigurimit (është lidhur Kontrata e Sigurimit).